



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Fondacionet Komunitare

Një vështrim i përgjithshëm i
karakteristikave dhe rëndësisë
së tyre në Evropë dhe botë

FONDACIONET KOMUNITARE

Një vështrim i përgjithshëm i karakteristikave dhe rëndësisë së tyre në Evropë dhe botë

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Tiranë, Shqipëri 2020

Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as cilindo person që vepron në emër të tyre, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që përmban ai.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

Email: info@resourcecentre.al

Website: www.resourcecentre.al

Adresa: Rruga e Elbasanit, PARK GATE, 10th Floor, Ap. 71/73, Tirana

Telefon: 00355 4 2254 881

Autor:

Ramadan Sopot

Kostandina Këruti

Grafika dhe Design:

Kristina Lato

TABELA E PËRMBAJTJES

Fondacionet Komunitare	5
Çfarë janë Fondacionet Komunitare?.....	6
Koncepti i Fondacioneve Komunitare	7
Fondacionet Komunitare në Evropë	8
Burimi i të ardhurave.....	11
Vlera e shtuar e Fondacioneve Komunitare.....	15
Organizatat mbështetëse	16
Fjalor	17
Referenca.....	19

Parathënie

Përgjatë tre dekadave të veprimtarisë së sektorit jo-fitimprurës diversifikimi dhe qendrueshmëria financiare ka qenë dhe vazhdon të jetë një ndër sfidat kryesore për organizatat jo-fitimprurëse (OJF). Shumë organizata në vend, varen nga fonde me bazë projektesh të mbështetura nga donatorë, kryesisht donatorë ndërkombëtarë. Mbështetja dhe fondet e shtetit ndër vite, si financiare dhe jo-financiare, mbetet në nivele të ulta.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, sjellin në vëmendje të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve e aktorëve të tjerë këtë hulumtim me qëllim prezantimin e fondacioneve komunitare, në mbështetje të fuqizimit të sektorit të shoqërisë civile e komuniteteve lokale.

Në botë, fondacionet komunitare po njihen si struktura të rëndësishme që i përgjigjen çështjeve të menjëhershme dhe afatgjata të komuniteteve lokale. Ato arrijnë të maksimizojnë burimet dhe pasuritë lokale, burimet njerëzore, kontribuojnë të fuqizimin e komuniteteve të cilave u shërbejnë dhe nxisin bashkëpunimin ndërmjet individëve, institucioneve publike dhe private, entiteteve të tjera për të zhvilluar dhe forcuar komunitetin.

Ky hulumtim synon të ofrojë një informacion të përgjithshëm mbi fondacionet komunitare dhe karakteristikat e tyre, shifra dhe fakte bazuar në një vështrim global mbi fondacionet komunitare, si dhe parashtron rolin e tyre të rëndësishëm për zhvillimin e komuniteteve që u shërbejnë.

Fondacionet Komunitare

Cfarë janë Fondacionet Komunitare?

Në mbarë botën, ka histori individësh filantropë të cilët kanë shfaqur natyrën e tyre të solidaritetit dhe bamirësisë për një kohë të gjatë, me qëllimin e vetësigurimit e mirëqenies së komuniteteve në nevojë. Shumica e akteve të dhurimitose bamirësisë bëhen në mënyrë joformale, në kohë krizash, si pjesë e besimevedhe traditave familjare, personale, angazhimit dhe ushtrimit të besimeve fetare etj.

Procesi i ofrimit të mbështetjes nga vetë anëtarët e komunitetit, shfrytëzimi i burimeve komunitare për të adresuar më mirë sfidat ose për të përmirësuar cilësinë e jetës në një komunitet quhet **filantropi në komunitet**. Kjo është një qasje që synon zhvillimin e komunitetit me anë të ngritjes së fondeve, zhvillimit të kapaciteteve të komunitetit dhe forcimit të besimit përmes bashkëpunimit dhe fuqisë së përbashkët në vendimmarrje.

Filantropia në komunitet mund të jetë joformale, e menjëhershme, jo vetëm financiare por edhe në natyrë, por mund të marrë edhe një formë më të strukturuar. Individët mund të krijojnë organizata filantropike komunitare që punojnë për të përmirësuar cilësinë e jetës në një komunitet.

Duke mbledhur, menaxhuar dhe shpërndarë burime të ndryshme dhurimesh. Një organizatë filantropike komunitare ka një qasje të mbështetjes së qendrueshme, afatgjatë për plotësimin e nevojave të komunitetit. Sot, një nga format në zhvillim të shpejtë të filantropisë në komunitet janë **fondacionet komunitare**.

Gjatë viteve të fundit, pritshmëritë për një rol më të zgjeruar të filantropisë private në zgjidhjen e problemeve sociale janë rritur. Shumica e këtyre pritshmërive përqendrohen në aftësinë e organizatave filantropike për të rritur kapacitetet e komuniteteve lokale për të zgjidhur problemet komplekse dhe sfiduese me të cilat ata përballen. Ky fokus në nivel komuniteti, sugjeron që fondacionet komunitare me natyrën e tyre unike, mund të luajnë një rol kryesor.

Filantropia komunitare paraqitet në një larmi formash organizative, duke përfshirë këtu por pa u kufizuar në: fonde të bazuara në identitet¹, rrathë dhurues², fondacione komunitare³, fondacione fetare, banka të rinjve⁴, grupe vullnetare dhe kooperativa (Franklin, 2017) (Hodgson, 2016).

Fondacionet komunitare nuk janë një fenomen i ri, i pari u formua në Shtetet e Bashkuara më shumë se 100 vjet më parë. Sidoqoftë, vitet e fundit ato kanë përjetuar një rritje të jashtëzakonshme pasi individët dhe institucionet kuptuan se fondacionet komunitare, përmes fondeve me qëllim filantropik, për komunitete lokale, mund të plotësojnë nevoja në një mjedis që ndryshon me ritme të shpejta.

Një konsensus i gjerë po zhvillohet në lidhje me dobbinë e konceptit të fondacioneve komunitare. Individët, organizatat mbështetëse, financuesit dhe në disa raste, qeveritë kanë marrë drejtimin në zhvillimin e fondacioneve komunitare në zonat e tyre, edhe pse me këndvështrime të ndryshme. Disamund të jenë të përfshirë në organizata të shoqërisë civile që punojnë për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në qeveri dhe nxitje vullnetarizmin; të tjerë mund të mbështesin projekte zhvillimi komunitare, duke identifikuar dhe gjetur mënyra për të përmbushur nevojat sociale dhe ekonomike të komuniteteve, ose duke inkurajuar dhurimin në nivel lokal. Pra, si konkluzion është vënë re se për të arritur qëllimet e tyre, komunitetet duhet të zhvillojnë burime të qendrueshme në mbështetje të nismave lokale në terma afatgjatë, edhe pasi donatorët të jenë larguar. Është e rëndësishme të ketë një ndërthurje të burimeve lokale, ekspertizës, energjisë dhe angazhimit në nivele të ndryshme, për të siguruar qëndrueshmërinë e komuniteteve lokale.

Koncepti i fondacioneve komunitare është provuar të jetë një instrument fleksibël dhe i adaptueshëm për të përmbushur jo vetëm nevojat e menjëhershme, por edhe nevojat në ndryshim të komuniteteve me kalimin e kohës. Këto fondacione kanë treguar aftësinë për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve në nivelin lokal dhe dryshimeve që vijnë nga forcat e jashtme, përfshirë uljet dhe ngritjet e cikleve ekonomike, evoluimin e mjediseve politike, kulturore dhe jofitimprurëse, efektet e globalizimit dhe programet e burokratizuara të mbrojtjes sociale. Ky koncept i thjeshtë por i jashtëzakonshëm dëshmon në kohë aftësinë e tij në plotësimin e nevojave të njerëzve, shoqërive dhe komuniteteve që i shërben.

¹Organizimi dhe aktivizimi i filantropisë brenda dhe midis grupeve të identitetit (p.sh. fondet e grave, dhurimet e diasporës etj.). Këto grupe të bazuara në identifikimin e tyre promovojnë demokratizimin e filantropisë nga bazat, ndërsa sigurojnë një mundësi për anëtarët e komuniteteve të marginalizuara që të fuqizohen dhe synojnë mbështetjen e tyre drejt çështjeve me rëndësi për atë komunitet.

²Një grup individësh që bëhen së bashku për të bashkuar burimet e tyre dhe diskutojnë se ku t'i japin këto burime. Procesi zakonisht përfshin takime në grupe dhe / ose ngjarje, të cilat njëkohësisht synojnë të informojnë anëtarët për çështjet e komunitetit dhe të ofrojnë mundësi për angazhim vullnetar.

³Grantimi i bamirësive publike, të cilat marrin fonde nga burime të ndryshme dhe zakonisht shërbejnë një zonë të caktuar gjeografike.

⁴Një model i angazhimit të rinjve me të cilin të rinjtë u jepet kontrolli për të vendosur mbi ndarjen e fondeve për projekte që drejtohen nga të rinjtë ose për projekte që adresojnë shqetësimet e të rinjve. Që nga viti 2014, ekzistojnë 216 Banka Rinore në 23 vende.

Koncepti i Fondacioneve Komunitare

Filantropia në komunitet e ka origjinën e saj në praktikën e gjatë të shkëmbimit, ndihmës së ndërsjellë, solidaritetit dhe zhvillimit të komunitetit. "Njerëzi lokalë qëndrojnë njëri-tjetrit duke shpërndarë burime për të mirën e përbashkët"- është një praktikë gjithëpërfshirëse e ndeshur në shumicën, nëse jo të gjitha, kulturat dhe komunitetet (Kilmurray, 2015).

Fondacionet komunitare janë njëkohësisht një formë dhe forcë për zhvillimin lokal që forcojnë aftësinë dhe zërin e komunitetit, ndërtojnë besim dhe më e rëndësishmja, kontribuojnë dhe ndërtojnë burimet lokale, të cilat gërshetohen për të ndërtuar dhe mbështetur një komunitet më të fortë (Hodgson, 2016)(Wilkinson- Maposa, 2018)

Fondacionet komunitare tradicionale kanë disa karakteristika të përbashkëta..Ato krijohen të ndikuar nga traditat lokale, historia dhe kultura për të përmbushur nevojat të një komuniteti në një zonë lokale. Fondacionet komunitare mund të shfaqin të gjitha, ose disa nga atributet e listuara më poshtë. Gjithashtu mund të pësojnë ndryshime në fokus e strukturë duke i përshtatur ato sipas rrethanave etipologjive të komuniteteve të caktuara lokale.

Fondacionet komunitare:

- përpiqen të përmirësojnë cilësinë e jetës në një zonë të caktuar gjeografike;
- janë të pavarur nga kontrolli ose ndikimi nga organizata, qeveri ose donatorë të tjerë;
- drejtohen nga një bord qytetarësh që reflektojnë gjerësisht qëndrimet për komunitetet ku shërbejnë;
- ofrojnë grante për grupe të tjera jofitimprurëse për të adresuar një larmi të gjerë të nevojave që shfaqen dhe ndryshojnë në komunitet;
- me kalimin e kohës kërkojnë të ndërtojnë, një fond prej dhurime të pa kushtëzuara dhe kushtëzuara nga një gamë e gjerë donatorësh, përfshirë qytetarë, organizata jofitimprurëse dhe biznese;
- sigurojnë shërbime të përshtatura sipas interesave dhe kapacitetit dhurues të donatorëve;
- ndihmojnë donatorët të arrijnë qëllimet e tyre filantropike dhe bamirëse;
- angazhohen në një sërë aktivitetesh – udhëheqjeje dhe partneriteti të komunitetit, duke shërbyer si katalizatorë, bashkëpunëtorë dhe lehtësues për të zgjidhur problemet dhe për të zhvilluar zgjidhje për çështje të rëndësishme të komunitetit;
- kanë politika dhe praktika të hapura dhe transparente për të gjitha aspektet e funksionimit të tyre; dhe
- i përgjigjen komunitetit duke informuar rregullisht publikun e gjerë për qëllimet, aktivitetet dhe statusin e tyre financiar.

Fondacionet Komunitare në Evropë

Sipas Iniciativës Evropiane për Fondacionet Komunitarenë (ECFI) në Evropë ekzistojnë më shumë se 800 fondacione komunitare, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në 29 vende. Këto fondacione mobilizojnë dhe investojnë burime teknike e financiare në një zonë gjeografike të caktuar.

Krahasimisht me kontinentet e tjera, Evropa ka treguar një zhvillim më të vonshëm të fondacioneve komunitare. Siç vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, mesatarja e vitit të krijimit të fondacioneve komunitare në Evropë është 2005, ndërkohë që Afrika listohet para Evropës me një mesatare të vitit 2001, dhe Oqeania 1999.

Figure 1: Mesatarja e krijimit të fondacioneve komunitare sipas kontinenteve



Burimi: *Community Foundations Atlas*

Ndërkohë një karakteristikë e zakonshme e fondacioneve komunitare është ajo e numrit të ulët të punonjësve. Në studimin e kryer nga Community FoundationsAtlas, në shkallë globale mesatarja e numrit të stafit të paguar në një fondacion.

komunitar është nga 2-5 persona ndërkohë që maksimumi i personave të punësuar në një fondacion komunitar është 280.

Vlen të theksohet fakti që në Evropë, ndonëse fondacionet komunitare janë më të reja në moshë ato reflektojnë një numër mesatar prej 8.8 personash, staf të paguar të ndjekur nga Amerika e Veriut me 7.7 dhe Azia me 7.4. Amerika e Jugut është ajo që paraqitet me mesataren më të ulët të stafit të paguar për fondacion komunitar me 2.8 persona.

Figure 2: Mesatarja e stafit të paguar të fondacioneve komunitare sipas kontinenteve



Burimi: Community Foundations Atlas

Fuqia e një Fondacioni komunitar për të përmirësuar cilësinë e jetës së komunitetit ku ai operon është e varur nga shuma e të ardhurave që ky fondacion arrin të gjenerojë në një kohë të caktuar. Ashtu siç shihet në grafikun e mëposhtëm, Amerika e Veriut dukshëm paraqitet me lartë krahasimisht me kontinentet e tjera me një mesatare prej 10.3 milion dollarësh, Azia në vend të dytë me 2.3 milion dollarë dhe Evropa në vend të tretë me 1.7 milion dollarë.

Figure 3: Mesatarja e të ardhurave vjetore të gjeneruara nga fondacionet komunitare sipas kontinenteve



Burimi: Community Foundations Atlas

Një nga funksionet kryesore të fondacioneve komunitare është dhënia e granteve për mbështetjen e nismave lokale nga individët apo organizatat që operojnë në atë komunitet. Duke marrë parasysh shumën e të ardhurave vjetoretë sipërpërmendura, Amerika e Veriut paraqitet me shumën më të lartë të dhënëpërmjet granteve me rreth 5.5 milion dollarë mesatarisht ose ndryshe 53% të të ardhurave. Ndërkohë Azia paraqitet me një shumë prej 1.65 milion dollarësh, porskrahuar me të ardhurat e tyre ata japin 72% të të ardhurave nëpërmjet granteve. Fondacionet komunitare në vendet e Oqeanisë japin grante me vlerëmesatarisht 793 mijë dollar ose 56% të të ardhurave të tyre.

Ndërkohë ajo çka është interesante dhe vlen të analizohet është Evropa, e cilapavarësisht se ndodhet në vendin e tretë për sa i përket të ardhurave mesatare me 1.68 milion dollarë duke treguar që filantropia në Evropë është në nivele të konsiderueshme, por norma e dhënies së granteve në raport me të ardhurat mbetet në nivele më të ulëta se të gjitha kontinentet në vetëm 16%. Kjo tregonse fondacionet komunitare në Evropë, kanë një fokus ndryshe nga kontinentet etjera, siç tregohet në Fig. 4.

Figure 4: Mesatarja vjetore e granteve të akorduara nga fondacionet komunitare sipas kontinenteve



Burimi: Community Foundations Atlas

Burimi i të ardhurave

Globalisht, ndryshimet më të mëdha në mënyrat se si funksionojnë fondacionet komunitare qëndrojnë në llojet e mbështetjes financiare që ata tërheqin, veçanërisht llojet e donatorëve, dhe ndikimi që dhurimet e tyre kanë në qëndrueshmërinë e këtyre fondacioneve. Në Amerikën e Veriut, veçanërisht në SH.B.A. dhe Kanada, mbështetja e madhe për fondacionet komunitare vjen nga donatorë individë. Ndërsa në ato vende ku fondacionet komunitare janë një formë e re e filantropisë në komunitet, dhe veçanërisht në zonat ku burimet e individëve mund të jenë më të kufizuara, janë bizneset lokale, dhe fondacionet vendase së bashku me ato ndërkombëtare të cilët janë mbështetësit më të mëdhenj. Në disa zona, institucione qeveritare qendrore dhe lokale luajnë një roltë madh në sigurimin e fondeve, veçanërisht për grantdhënie.

Institucionet I shohin fondacionet komunitare si një mënyrë efektive për të identifikuar dhe financuar organizatat lokale që adresojnë nevojat e komunitetit lokal.

Dhurimet e kushtëzuara nuk janë të lehta për tu kuptuar, veçanërisht në zonat kunevojat lokale janë të mëdha. Si rezultat, në shumë vende donatorët - qoftë individë, korporata, fondacione, qeveri dhe entitete qeveritare - duan që dhurimet e tyre të kenë ndikim të menjëhershëm. Ndërtimi i fondeve të përhershme nga dhurimet e kushtëzuara për të siguruar qëndrueshmëri mbetet për shumë fondacione komunitare një qëllim që ata aspirojnë më shumë sesa njërealitet i afërt.

Dy atributet më të rëndësishme të fondacioneve komunitare janë respektimi i tyre ndaj politikave dhe praktikave të hapura dhe transparente, dhe përgjegjshmëria e tyre ndaj publikut të gjerë. Faktori më i rëndësishëm në krijimin e një fondacioni komunitar është besimi nga publiku - besimi që organizata është e pavarur nga ndikimi, se është një ndërmjetës i ndershëm dhe do të bëjë atë që thotë se do të bëjë. Donatorët lokalë nuk do të dhurojnë përmes një organizate ndërmjetësenëse ata nuk kanë besim e që shohin që dhurimi i tyre do të jetë më efektiv dhe sesa dhurimi ad-hoc te një person siç ata janë mësuar. Përmes hapjes dhe transparencës së tyre, fondacionet komunitare shpesh kanë shtruar rrugën nëkrijimin e kulturave të filantropisë dhe sigurimin e një modeli se si duhet të veprojnë organizatat e tjera jofitimprurëse.

Kush është “Donatori” për një fondacion komunitar?

Kur shumica prej nesh mendojnë fjalën "donator", veçanërisht në një kontekst ndërkombëtar, ne priremi të mendojmë për institucione si - fondacione, agjensitëe ndihmës bilaterale, etj. Fondacionet komunitare ofrojnë një karakterizim më tëzgjeruar dhe ngjyruës të fjalës, e cila thekson përzierjen e qëllimshme të burimeve

nga tre lloje të ndryshme të "donatorëve". Këta janë donatori i jashtëm, vetëfondacioni komunitar dhe njerëzit që bëjnë pjesë në komunitet.

Donatori i jashtëm. Këtu, kemi të bëjmë me fondacione, donatorë bilateral dhe agjensi të tjera zhvillimi të cilat nuk janë të bazuara në komunitet ose janë një hap larg komunitetit ose kontekstit në të cilin ata financojnë. Për shumë donatorë, edhe kur ata janë të interesuar të mbështesin iniciativa të vogla në nivel lokal, për ta thjesht nuk është praktike, kosto- efektive, apo e arsyeshme për të dhënë shumë grante të vogla. "Problemi" i tyre është kostoja fikse e dhënies së granteve, që do të thotë se ekziston një madhësi minimale e grantit nën të cilën dhënia e fondeve bëhet jo praktike dhe e kushtueshme. Shpesh duke punuar nga distanca, këta donatorë kanë nevojë për partnerë me aftësi menaxhuese të theksuara që mund të përmbushin kërkesat e nevojshme institucionale për raportim, matje dhe përgjegjësi. Në këtë mënyrë, donatorët e jashtëm jo vetëm që janë mbështetës financiar, por shërbejnë dhe si një mekanizëm për nxitjen e krijimit të fondacioneve komunitare dhe zhvendosjes së fuqisë së tyre në komunitetet lokale.

Njerëzit në komunitet. Në fondacionet komunitare çdokush mund të jetë një dhurues, dhe nuk po flasim vetëm për ata të cilët kanë burime financiare, por përkundrazi për një zhvendosje të mendimit që manifeston dhënien si një akt empatie, pjesëmarrjeje, dhe si një shprehje besimi. Në kontekstin e financimit për zhvillimin e komunitetit lokal dhe ndryshimet shoqërore, kontributet individuale nga "njerëzit e thjeshtë" - për shkak se ata kujdesen ose besojnë në një kauzë ose një vend - mund të jenë një faktor i rëndësishëm ndryshimi.

Individët gjithashtu mund të kontribuojnë në mbështetjen e punës së fondacioneve komunitare përmes dhurimeve të kushtëzuara.

Çfarë është një “dhurim i kushtëzuar”?

Një dhurim i kushtëzuar është një shumë e parash, zakonisht relativisht e madhe, që investohet në mënyrë të tillë që rritet me kalimin e kohës për të ruajtur fuqinë e saj blerëse dhe bën shpërndarjet në mënyrë periodike, shpesh herë me bazë vjetore. Fondacionet komunitare grumbullojnë investimin e përfituar nga dhurimi i kushtëzuar për të përmbushur strategjitë e tyre afatgjata.

Shumë fonde përbërëse të dhurimeve të kushtëzuara vijnë nga dhuratat e pasurive të marra pas vdekjes së dhuruesve, në bazë të një marrëveshje të nënshkruar midis këtyre të fundit dhe fondacionit komunitar. Në varësi të natyrës dhe strukturës së marrëveshjes, dhurimi i kushtëzuar jepet për një periudhë të gjatë ose për një periudhë të caktuar kohore.

Por kush është “Komuniteti” në Fondacionet Komunitare?

Fjala "komunitet" përdoret së tepërmi në filantropi dhe zhvillim, ndaj duhet të ndalemi një moment të qartësojmë se çfarë kuptojmë kur themi komunitet. "Komuniteti" përcaktohet më së shpeshti nga gjeografia, por ai gjithashtu mund të përcaktohet nga identiteti, interesat dhe vlerat e përbashkëta, veçanërisht tanime përhapjen e grupeve të mediave sociale, që lejojnë njerëzit të mblidhen dhe mobilizohen virtualisht.

Komuniteti gjithashtu mund të jetë një zinxhir i lidhjeve midis njerëzve dhe një zhvendosje nga individit në kolektiv. Ai ka një funksion të dyfishtë, atë "bashkues"përmes një ndjenje të përbashkët të përkatësisë dhe sigurimit të një "motori" që mund t'i lejojë kolektivit të shprehë zërin dhe të veprojë në lidhje me të tjerët. Mefjalë të tjera, komunitetet krijojnë hapësira për njerëzit të shoqërohen, si dhe të organizojnë, artikulojnë dhe praktikojnë të drejtat e tyre.

Vlera e shtuar e Fondacioneve Komunitare

Fondacionet komunitare përtej aftësisë së tyre për të zhvilluar komunitetin e tyre lokal duke forcuar aftësinë dhe zërin e komunitetit me anë të burimeve lokale me qëllim për të përmirësuar cilësinë e jetës së komunitetit, sjellin një sërë përfitimesh të tjera për komunitetin si:

- **Mësojnë dhe promovojnë filantropinë.** Një nga rolet kryesore të fondacioneve komunitare është të mësojë individin dhe komunitetin në përgjithësi për vlerat e filantropisë dhe të marrin përgjegjësinë personale për përmirësimin e zonave të tyre lokale. Ky rol kapërcen kufijtë kulturorë dhe shtetëror.⁵

- **Veprojnë si organizata ndërmjetëse:** Fondacionet komunitare në shumicën

e rasteve nuk ofrojnë shërbime direkt për individët apo zbatojnë programe në komunitet. Ata janë organizata që mbledhin fonde dhe ofrojnë grante për organizatat jofitimprurëse në mënyrë që të mbështesin infrastrukturën lokale dhuruese dhe të adresojnë ndryshimin e nevojave të komunitetit⁶.

- Fondacionet komunitare kanë aftësinë të përthithin burimet e jashtme për të adresuar nevojat e komunitetit në mënyra që menaxhohen dhe kontrollohen nga drejtuesit lokal, të cilët, të ndjeshëm ndaj nevojave të komuniteteve të tyre, **vendosin axhendën e zhvillimit**⁷.

- **Rrisin përgjegjshmërinë dhe standardet e funksionimit të organizatave**

jo-fitimprurëse: Si dhënës të granteve, fondacionet komunitare kanë përgjegjësi

të kontrollojnë nëse fondet e tyre janë shpenzuar mirë. Fondacionet komunitare kanë qenë aktive në përcaktimin dhe ngritjen e standardeve të funksionimit të sektorit jofitimprurës që ata financojnë.

⁵Alexeeva, Olga. "Community foundations in a country without a community," Alliance Magazine (1 September 1998). Available at: www.alliancemagazine.org/en/content/community-foundations-a-country-without-a-community

⁶Piepenburg, Erik. "Cleveland's Thriving Theatre Hub Lures Residents," Neë York Times, April 2, 2014, p. B6.

⁷Hodgson, Jenny. "Tracking the growth of organized community philanthropy: Is it the missing piece in community development" 2013 State of Civil Society Report, Civicus, Ch. 24, pp. 237-243. Hodgson, Jenny, Barry Knight &

Alison Mathie. "The New Generation of Community Foundations," Global Fund for Community Foundations and Coady International Institute, March 2012. Knight, Barry and Andrew Milner. "What does community philanthropy look like? Case Studies on Community Philanthropy, Vol. 1. Centris, 2014. All of these articles are available on the Global Fund for Community Foundations website: www.globalfundcommunityfoundations.org

Organizatat mbështetëse

Organizatat mbështetëse janë institucione të cilat ofrojnë ndihmë teknike përfondacionet komunitare. Ato shërbejnë gjithashtu si zëri promovues për fushën e tyre. Pavarësisht nëse fokusi i tyre është kombëtar, rajonal, ose ndërkombëtar, organizata të tilla ndihmojnë në promovimin dhe profesionalizimin e fushës së fondacioneve komunitare. Pjesërisht, ata e bëjnë këtë duke zhvilluar, mbledhur dhe shpërndarë materiale burimore, dhe gjithashtu duke mbrojtur një mjedis që është fiskalisht dhe ligjërisht mbështetës i fushës.

Organizatat mbështetëse janë si “miq të mençur” ose më të mirë, këshilltarë të besuar, konfidencialë, asistentë personalë, tutorë, mentorë, dhe engjëj mbrojtës. Ndërkohë që organizatat mbështetëse promovojnë filantropinë, rezultati është shumë fondacione komunitare dhe më shumë para për filantropi. Organizatat mbështetëse veprojnë për të përmirësuar dhe promovuar filantropinë, ndërkohë që fondacionet komunitare përmirësohen, bëhen më profesional, duke përfshirë më shumë partnerë dhe duke pasur më shumë ndikim në këtë fushë.

Ajo çka është me e rëndësishme është se organizatat mbështetëse mund të lehtësojnë ndjenjën e izolimit të fondacioneve komunitare duke u mundësuar atyre të arrijnë kolegët e tyre dhe t'u japin atyre "një ndjenjë përkatësie".

Disa prej roleve praktike të organizatave mbështetëse janë:

- **Informues** (përmes materialeve burimore si gazeta, direktori, raportet akimesh dhe konferencash, faqe në internet)
- **Lehtësues** (i takimeve, seminareve, mundësive të rrjetëzimeve dhe koalicioneve)
- **Edukues/ trajnues** (duke ofruar apo mundësuar programe mësimore dhe trajnimi)
- **Monitorues** (duke ofruar larmi dhe veprime vijuese për kërcënimet e qeverisë, biznesit dhe organizatave jo-fitimprurëse në terren)
- **Përfaqësues** (duke ofruar një zë të përbashkët për çështjet kryesore)
- **Ofruesi i forumit** (duke ofruar një pike qendrore për diskutimin e çështjeve urgjente)

Partnerët Shqipëri është një prej 27 organizatave në Evropë, të identifikuara si organizata mbështetëse për fondacionet komunitare, të cilat janë pjesë e inicativës Evropiane për Fondacione Komunitare⁸.

⁸<https://www.communityfoundations.eu/community-foundations-in-europe/atlas-support-organizations.html>

Fjalor

Donatorë – Individ, grup apo entitet që kryhen një dhurim

Dhurime të kushtëzuar - Janë dhurime që i nënshtrohet një kërkesë ku principlali (shuma e dhuruar) të mbahet e paprekur dhe të investohet për të krijuar një burim tëardhurash për një fondacion. Donatorët mund të kërkojnë që principlali të mbetet i paprekur në vazhdimësi, ose për një periudhë të caktuar kohe, derisa të akumulohenmjete të mjaftueshme për të arritur një qëllim të caktuar.

Financues – një donator, korporatë, fondacion komunitar, etj që sigurojnë një grant për një organizatë jo-fitimprurëse për projektet dhe ose programet.

Filantropi - filantropia përfshin konceptin e dhurimit vullentar nga një individ apo gruppër të promovuar të mirën e përbashkët. Filantropia gjithashtu zakonisht i referohetgranteve të parave të dhëna nga fondacionet për organizata jofitimprurëse. Filantropia adreson kontributin e një individi ose grupi në organizata jo-fitimprurëse të cilat punojnëpër shkaqet e varfërisë ose problemeve sociale, përmirësimin e cilësisë së jetës për tëgjithë qytetarët. Dhurimi filantropik mbështet një sërë aktivitete, përfshirë kërkimin, shëndetësinë, arsimin, artin dhe kulturën, si dhe zbutjen e varfërisë dhe në thelb të saj qëndron sjellja e një ndryshimi për të mirën e përbashkët.

Fondacioni komunitare - Një organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që punon në njëzonë gjeografike e cila, me kalimin e kohës, ndërton një kapital përmes fondeve të dhuruara nga shumë donatorë në komunitet. Ofron shërbime për komunitetindhe donatorët e tij, krijon skema grantesh, dhe ndërmerr udhëheqjen e komunitetit dheaktivitete që synojnë partneritete me qëllim adresimin e nevojave të komunitetit. Një fondacion komunitar është një mjet për donatorët lokalë që dëshirojnë të kontribuojnë me para, aksione me bursa, testament ose pronë të tyre të patundshme për të krijuar dhurime të përhershme që do të përfitojnë ngabashkësia në përjetësi. Detyra e fondacioneve komunitare është të krijojnëfonde të konsiderueshme, të përhershme nga të cilat jepen në formë grantesh për organizatat lokale të komunitetit.

Grantdhënie – Një fond i fituar nga një organizatë apo individ për të kryer aktivitete jo-fitimprurëse në komunitet

Organizatë filantropike komunitare – Një organizatë e pavarur, jo fitimprurëse e krijuarpër të mbledhur, manaxhuar dhe rishpërndarë burime financiare dhe burime të tjera të dobishme për mirëqënien e komunitetit.

Organizatë publike bamirëse – në kontekstin amerikan është një organizatë jo fitimprurëse e cila është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat dhe përfiton mbështetjefinanciare nga një segment i gjerë i publikut. Institucionet fetare, edukuese dhe shëndetësore vlerësohen të jenë organizata publike bamirëse. Organizatat e tjera duhettë kalojnë një test për të përfituar këtë status.

Referenca

Franklin. (2017).

Hodgson, P. (2016). *The Rise of Community Philanthropy.* *Alliance Magazine Volume 21(4): 31-35.*

Kilmurray, Z. (2015). *Participatory decision-making in contested societies: Examples from the field of community philanthropy.*

Ëilkinson-Maposa, S. (2018). *Vitality and commotion: exploring emergent institutional formations of community philanthropy.* *Paper Sector Research (ISTR) Conference, Amsterdam, July 2018.*

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

www.resourcecentre.al

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA). Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.